



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1579/2 prot.,

Datë 07.07.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-72698-06-15-2023, me objekt: “*Blerje uniforma per Policinë Bashkiake*” me fond limit 6,833,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës

**Ankimues:** “Malbertex” SHPK  
Rruga Siri Kodra Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës  
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

Në datën 06.07.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1579 protokollit e operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-72698-06-15-2023, me objekt: “*Blerje uniforma per Policinë Bashkiake*” me fond limit 6,833,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1579prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

“Nuk permbush piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik, te ndryshuar me Shtojcen e dates 22.06.2023, ku citohet se “OE ofertues duhet te paraqese certifikate konformiteti produkti per artikujt: Xhup sipas standarteve SSH/ EN 343:2019; SSH/ EN ISO 20471:2013; SSH/ EN ISO 13688:2013; SSH/ EN 342:2017”, pasi pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur, konstatohet se operatori ekonomik ofertues nuk ka paraqitur certifikate konformiteti te vlefshme, sipas kerkesave te AK ne dokumentat e tenderit. .”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 07.07.2023

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**